

I nderuar z. Aliu, kryetar i Bordit të Drejtorëve të Shoqatës së Bankave
I nderuar z. Balija, kryeshef ekzekutiv së Shoqatës së Bankave
I nderuar z. Rexhepi, drejtor i STRAS-it
Zonja dhe zotërinj,

Duke falënderuar Shoqatën e Bankave dhe EFSE-n për organizimin e kësaj ngjarjeje, më lejoni t'ju drejtohem me një fjalë rasti.

Ndër sfidat kryesore në bankingun modern është avancimi i bankingut dixhital, që klientëve t'u mundësohet të kryejnë aktivitete bankare pa u obliguar të paraqiten fizikisht në sportelet bankare. Jemi dëshmitarë të avancimit të vazhdueshëm nga bankat në funksion të dixhitalizimit bankar, ku ndër format më të theksuara është e-bankingu e që në kohët të fundit u mundësohet klientëve t'i qasen llogarive të tyre në kohë reale, si dhe të kryejnë transaksione bankare qoftë edhe nga pajisjet telefonike.

Avancimi i përdorimit të parasë dixhitale është proces tredimensional. Pa dyshim që hallka e parë e këtij zinxhiri fillon nga BQK-ja. BQK si rregullator dhe mbikëqyrës i sektorit bankar e financiar ka për obligim që të siguroj infrastrukturën ligjore e rregullative adekuate në funksion të avancimit të bankingut në Kosovë. Duhet cekur që baza ligjore në fuqi mëton standardet ndërkombëtare bashkëkohore. Që nga ky vit është filluar me zbatimin e shërbimit të pagesave në kohë reale apo RTGS, që paraqet një arsye shtesë që të përdoren sa më shumë bankat për pagesa në vend se ato të bëjnë pagesa më mënyrën klasike.

Hallka e dytë në funksion të avancimit të shërbimeve bankare dixhitale janë vet bankat në Kosovë. Ato duhet që të ofrojnë kushte apo me fjalë të tjera të joshin klientët që të përdorin e-bankingun. Duhet të pranojmë faktin dhe të anticipojmë me zhvillimet që janë bërë viteve të fundit, ku gama e mundësive të përdorimit të shërbimeve dixhitale është shumë e madhe dhe krahasohet me atë të vendeve të zhvilluara. Sot, klienti kosovar ka mundësi që të kryej gati të gjitha transaksionet bankare e më gjerë duke përdorur sistemin e-banking. Bankat janë ato që duhet të prijnë në këtë proces përmes nxitjes së klientëve të kalojnë nga klientët klasik në klientë dixhital. Kjo, padyshim që arrihet edhe përmes balancimit të kostove, respektivisht ofrimit të mundësive që Banking dixhital të jetë më pak i kushtueshëm se ai klasik. Duke qenë të vetëdijshëm se jemi në ekonomi të tregut, çështja e provizioneve të aplikuara duhet të adresohet tutje nga bankat komerciale.

Hallka e tretë në këtë proces janë vet klientët e bankave të cilët çdo ditë e më shumë janë duke përdorur shërbimet dixhitale. Bazuar në publikimet e BQK-së, vërejmë se numri i përgjithshëm i transaksioneve ndërbankare gjatë vitit 2015 arriti në rreth 9.8 milionë transaksione, numër ky i shumëfishuar në krahasim me vitin 2012 që ishte 4.3 milionë euro. Vetëm për periudhën gjashtëmujore janar-qershor 2016 numri i transaksioneve bankare arriti në 5.4 milionë euro që jep garanci që deri në fund të vitit ky numër do të jetë dyshifror, duke vënë në pah besimin që kanë qytetarët e Kosovës në sistemin bankar dhe rritjen e

ndërmjetësimit bankar në kontekst të kryerjes së pagesave pa para të gatshme. Sa i përket vlerës, në vitin 2015 ajo arriti në 7.5 miliardë euro (vlera e pagesave ndërbankare) krahasuar me 5.7 miliardë euro sa ishte në vitin 2012. Që këto shifra të jenë më kuptimplotë dhe të paraqesin avancimin e bërë në këtë drejtim është fakti që vlera mesatare për transaksion në vitin 2012 ishte 1325 euro duke u zvogëluar në 765 euro në vitin 2015. Kjo edhe një herë tregon që mundësitë që ofrojnë bankat lidhur me pagesat pa para të gatshme janë të mirëpritura nga klientët që përdorin bankingun dixhital edhe për pagesat në vlera nën 1000 euro.

Në fund të tremujorit të dytë të vitit 2016 numri i llogarive të cilave klientët mund t'iu qasen përmes internetit arriti në 215,233 që krahasuar me vitin 2015 paraqet rritje prej rreth 14.92 përqind, ose rritje shumë fish më e madhe krahasuar me vitin 2012 e që ishte 97,089 llogari bankare. Rritja e numrit të përdoruesve të shërbimit e-banking zvogëlon në masë të madhe edhe pagesat në para të gatshme, i cili është edhe njëri nga qëllimet e institucioneve financiare në vend. Kryerja e transaksioneve përmes shërbimit e-banking është një formë mjaft efikase dhe e sigurt, pasi që klientët kursejnë kohë dhe transaksionet mund t'i kryejnë në çdo kohë dhe nga çdo vend.

Pasi që tetë nga gjithsej dhjetë bankat e licencuara janë banka me kapital të huaj, që përveç atraktivitetit të këtij sektori nga investitorët e jashtëm, paraqet edhe përparësi në funksion të prurjes së përvojave të reja bankare në tregun kosovar. Kjo është shprehur edhe në konkurrencën që kanë krijuar ato në funksion të avancimit të shërbimeve pa para të gatshme.

Në fund, duke qenë mirënjohës për kohën tuaj, ju falënderoj!